

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

**29.05.2023
Ora 11:40**

RENDI I DITËS

**Shorti “Për caktimin e relatorit për kërkesën ankimore numër 92, subjekti ankues
PDIU”.**

PJESËMARRJA :

Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.

Z. Y. Merkaj: Atëherë, përshëndetje të gjithëve! Sot në datën 29.05.2023 ora 11:40, zhvillohet seanca shortit për caktimin e relatorit, për kërkesën ankimore nr. 92, paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nga subjekti zgjedhor Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet, e cila ankimon vendimin e KSHZ “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për zonën zgjedhore, Bashkia Librazhd”. Ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për Këshillin e Bashkisë Librazhd. Për këtë i referohemi nenit 14 të Rregullores së KAS-it. Kemi përgatitur pesë shirita letre, ku në njërin është shënuar kërkesa ankimore nr. 92. Katër shiritat e tjerë janë të bardhë dhe pa shënime. Palosen shiritat e letrës dhe futen në pesë gogla, me peshë formë dhe ngjyrë të njëjtë, në një enë transparente. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë të pranishëm në seancë, kanë autorizuar një përfaqësues të KQZ-së, të tërheqi goglat në emër dhe për llogari të tyre. Duke filluar nga rendi alfabetik rritës me zotin Elvin Lako, Elvis Çefa, Ilirjan Rusmali Koli Bele dhe në fund zotin Ledio Braho. Përzjehen dhe

- Tërhiqet gogla, në emër dhe për llogari të:

Zotit Elvin Lako – shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

- Tërhiqet gogla, në emër dhe për llogari të:

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

Zotit Elvis Çefa - kërkesa ankimore numër 92.

- Tërhiqet gogla, në emër dhe për llogari të:

Zotit Ilirjan Rusmali - shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

- Tërhiqet gogla, në emër dhe për llogari të:


Zotit Koli Bele - shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

- Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Zotit Ledio Braho: - shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Në përfundim të procedurës së shortit relator i kërkesës ankimore nr. 92 është zoti Elvis Çefa. Me kaq përfundon dhe procedura e shortit, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

29.05.2023
Ora 12.30

RENDI I DITËS

“Për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 87, subjekti ankues: Partia Socialdemokrate e Shqipërisë”.

PJESËMARRJA:

- **KAS-i:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
- **Stafi i KQZ-së:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **PARTI POLITIKE :** PSD (I. Hoxha)

Z. E. Lako: Mirdita, të gjithëve! Çelim sot seancën e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve për verifikimin dhe plotësimin elementeve të formës dhe të përmbajtjes për kërkesën ankimore nr. 87 datë 25.05.2023 të paraqitur nga Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, me objekt: kundërshtimi i vendimit nr. 540 datë 20.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për tabelën përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për kryetar të bashkisë dhe për këshillin e bashkisë në zonën zgjedhore Bashkia Korçë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Nëpërmjet këtij ankimi është kërkuar rinumërimi i votave për këshillin bashkiak në 59 kutitë e votimit për KZAZ-në nr. 74 dhe ndryshimi i rezultatit të miratuar nëpërmjet vendimit nr. 540 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, duke pasqyruar rezultatet e rinumërimit të këtyre kutive në tabelën

1

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

përmbledhëse. Relatori i kësaj seance jam zgjedhur unë, Elvin Lako, sipas shortit të hedhur në KQZ. Të pranishëm jemi tre anëtarë për momentin, të KAS-it, kështu që e kemi kuorumin e nevojshëm për të vazhduar me shqyrtimin e kësaj çështjeje. Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve e përfaqësuar nga sekretari i Përgjithshëm. Për palën ankuese?

(Diskutim pa mikrofon)

Mirë, s'ka nevojë, rrini ulur, vetëm me mikrofon, ju lutem, dhe autorizimin.

Z. I. Hoxha: Përfaqësuesi i autorizuar, Ilirjan Hoxha.

Z. E. Lako: Faleminderit! Palë të interesuara nuk ka dhe asnjë kërkesë nuk ka. Ndonjë kërkesë paraprake për konflikt interesi për KAS-in, apo diçka tjetër nuk ka. Mirë, shkurtimisht, zoti Merkaj, dy fjalë në lidhje me plotësimin e elementeve të formës dhe të përmbajtjes në lidhje me këtë çështje.

Z. Y. Merkaj: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore nr. 87 me ankues Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, e cila ankimon vendimin e Komisionierit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr. 540 datë 20.05.2023, i cili ka miratuar tabelën përmbledhëse të rezultatit për kryetar dhe për këshillin e bashkisë, zonën zgjedhore Bashkia e Korçës, për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Nga verifikimi paraprak i elementeve të formës dhe përmbajtjes konstatohet se nuk i plotëson elementet e formës pasi i mungon përshkrimi i shkurtër i shkeljes, baza ligjore, përshkrimi i fakteve dhe argumenteve, tek të cilat mbështetet ankimi, si dhe tregimi i provave, të cilat kërkon të marri gjatë procesit. Në këto kushte, i kërkojmë



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

KAS-it të kthehet për plotësim me këto elemente. Është një arsyetim i përgjithshëm, që nuk kuptohet çfarë kërkon dhe ku e gjejnë provën. Faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit, zoti Merkaj! Fjala për ju, për palën ankuese, duke pasur parasysh dhe çfarë u relatua nga administrata, nga sekretari i Përgjithshëm, në lidhje me plotësimin e elementeve të formës dhe të përmbajtjes. Pra, pak a shumë, ankimi identifikohet subjekti që e ka bërë, është bërë brenda afatit, por ajo çfarë pretendohet ka të bëjë me shkakun ligjor dhe me provat dhe faktet në lidhje me çfarë ju pretendoni. Pra, pretendimi nuk duhet të jetë i përgjithshëm, por duhet të ketë fakte konkrete dhe prova. Çfarë keni për të thënë për këtë?

Z. I. Hoxha: Duke pasur parasysh të drejtën e përfaqësimit, që ka pasur subjekti ynë qoftë si subjekt i autorizuar për të caktuar anëtarët e Komisionit të Qendrës së Votimit, qoftë si subjekt që nuk ka pasur të drejtë të ketë numëruar në vendnumërimet e votave të kësaj KZAZ-je, të KZAZ-së nr. 74 në Korçë, ne kemi konstatuar nga të dhëna jozyrtare, sikurse i kemi pasqyruar në ankimin e paraqitur nga ana jonë, që grupe të caktuara të numërimit, me qëllime të paracaktuara kanë devijuar rezultatin e numërimit të votave, duke i konsideruar si vota të vlefshme një pjesë të votave të pavlefshme dhe duke i rishpërndarë këto vota për llogari të subjekte të tjera, kryesisht në bazë të informacioneve, që kanë disponuar, po themi, shtabi ynë elektorale në qytetin e Korçës, dhe kryesisht në favor të kandidatit të Partisë Agrare Ambientaliste, i cili kandidonte si kandidat për këshillin bashkiak të kësaj zonë zgjedhore. Duke mos pasur numëruar, ne nuk mund ta dokumentonim ose ta pasqyronim qëndrimin tonë në grupet e numërimit dhe të garantonim mostjetërsimin e kësaj vote, ose mosdeformimin e rezultatit zgjedhor. Njëkohësisht vëzhguesit tanë që kanë qenë në numërim, kanë vëzhguar dhe kanë ndjekur, si të



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

thuash, kanë ruajtur, kanë numëruar votat e vlefshme që kanë rezultuar si të tilla, për llogari të subjektit tonë dhe nuk kanë mundur të menaxhojnë njëkohësisht edhe procesin se çfarë ndodh me votat e pavlefshme, çfarë bën GNV –ja me votat e pavlefshme. Duke qenë në këtë situatë kemi parashtruar ankimet dhe pretendimet e ngritura nga shtabi ynë elektoral, sipas të cilit veprime të tilla kanë qenë të qëllimshme, të vlerësuara këto edhe në korelacion me faktin që një anëtare e ZAZ-së, përkatësisht kemi një Filloreta, një anëtare KZAZ-së me mbiemër Liçi, rezulton të jetë e afërme me e kandidatit të Partisë Agrare Ambientaliste dhe duke qenë në këto pozita mendojmë që edhe këta, si edhe vetë kjo, apo edhe vetë KZAZ-ja mund të ketë ndikuar në lënien në heshtje të një veprimi të tillë. Gjithsesi në këto situata ne nuk mund të disponojmë prova konkrete, jemi në situatën që kemi një dyshim të arsyeshëm, sepse vlerësojmë, në radhë të parë, nëse do t'i referohemi trendit mesatar të votave të pavlefshme, po themi, në rang qarku, por qoftë edhe në rang Republike, se ka pak a shumë njëfarë trendi, në përqindjen e këtyre votave në zona të caktuara, dhe faktit që kanë dalë njoftime dhe deklarime jozyrtare të personave, që mbase edhe kanë qenë vënë në dijeni apo mbase të përfshirë në këtë lloj procesi, jemi në situatën që neve pretendojmë që deformimi, pikërisht konsiderimi si vota të vlefshme i një pjesë të votave të pavlefshme dhe rishpërndarja e tyre në favor të subjekteve të treta kanë ndikuar, duke pasur parasysh edhe rezultatin faktik të publikuar në tabelën përmbledhëse dhe shpërndarjen e votave të vlefshme për gjithë kandidatët, për gjithë subjektet, çmojmë herësin, që rezulton në këtë njësi bashkiake, në këtë bashki, ne çmojmë që ky fenomen ka ndikuar në shpërndarjen e mandateve duke na çuar që të humbasim një mandat si subjekt në këshillin bashkiak të Bashkisë Korçë. Pra, më shumë se kaq ne nuk disponojmë. Dyshimi është i tillë, bazohet pikërisht në këto dhe ajo çfarë mendojmë që do ta zgjidhte

4

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

këtë situatë, në drejtim të asaj që të vlerësohej me korrektesë vota, ashtu sikurse është votuar nga zgjedhësit në këto zgjedhje, çmojmë që është e pranueshme dhe është i arsyeshëm kërkimi dhe i mbështetur, do të thoshim, në drejtim të respektimit të drejtës së votës e të respektimit të votave, ashtu sikurse votua qytetari dhe zgjedhësit që të krijohet mundësia e rinumërimit të këtyre kutive, vetëm për votat e hedhura në kutitë për këshillin bashkiak. Pra, si bazë ligjore ne e kemi cituar në kuptimin e të drejtës që na ofron ligji për të paraqitur një ankim, në rast se nuk biem dakord me tabelën. Fenomenin e kemi parashtruar sesi qëndron, dyshimet tona i kemi parashtruar, të cilat kuptohet, ne e kemi shprehur që janë të marra nga burime jozyrtare, sepse askush nuk mund të vijë këtu sot e të thotë që kemi bërë këtë fenomen ose X numërues ka bërë këtë lloj fenomeni. Pra, jemi në këtë situatë, që mendojmë që pikërisht rinumërimi i këtyre kutive, megjithëse kuptohet e vë në lëvizje të gjithë infrastrukturën zgjedhore, të gjithë komisionin dhe logjistikën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, por është një mekanizëm që garanton drejtësi dhe paanshmëri në shqyrtimin e ankesës sonë.

Z. E. Lako: Avokat, faleminderit! Ju, pak a shumë, referuat edhe një herë atë çfarë keni shkruar në ankimin tuaj. Ne e kemi parë ankimin edhe administrata e Komisionit e ka parë ankimin, problemi është që këtu vihet me pretendime, me fakte konkrete dhe mekanizmi ligjor që ju keni, si një subjekt zgjedhor, është që ju keni të drejtën, keni pasur të drejtën që në vendin e numërimit të votave të keni të atashuar vëzhgues dhe të shikonin gjatë procesit të numërimit që a ka vota të hequra, që kanë dalë në favor të subjektit tuaj dhe në tabelën përmbledhëse. Për shembull, të marr unë një rast, nuk janë pasqyruar, (ta mbaroj unë arsyetimin dhe pastaj mund të përgjigjeni dhe ju) dhe duhen prova konkrete në mënyrë që ne të

5

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

bindemi që ka prova të tilla që të plotësojmë pastaj kërkesën tuaj për të rinumëruar 1, 2, 5 a 59 qendra votimi, që ju keni kërkuar, por ne nuk mund të rinumërojmë 59 qendra votimi, thjesht me pretendime që mundet, pse disa anëtarë të KQV –ve janë të subjektit tonë, ata na kanë dhënë votën, po këto vota kanë shkuar ose të pavlefshme, ose janë rishpërndarë, meqenëse një anëtare e KZAZ-së kishte një të afërm që kishte një interes. Anëtari i KZAZ-së nuk numëron vota, numërojnë grupet e numërimit dhe nuk ka si të ndikojë, sepse grupet e numërimit të subjekteve zgjedhore janë ata që përpilojnë tabelat. Kështu që ajo çfarë tha edhe sekretari i Përgjithshëm, çfarë po kërkojmë dhe ne, ka të bëjë me faktin që ky ankim nuk mund të jetë i përgjithshëm, që ne mendojmë se i është bërë një padrejtësi subjektit dhe hajde të rinumërojmë edhe një herë të gjithë qarkun e të shohim se mos ka ndonjë votë aty brenda. Nuk funksionon kështu. Edhe në rastet të ngjashme ne kemi kërkuar prova konkrete, dhe kur KAS-i është bindur që ekzistojnë një ose disa prova të mjaftueshme për ne, që mund të ketë një devijim të rezultatit dhe pastaj kemi vazhduar me vendimmarrjen përkatëse. Kështu që ajo çfarë unë kërkova kishte të bënte, që mundet ju të plotësoni ankimin me diçka konkrete, sepse kjo që keni sjellë ju është një gjë e përgjithshme, që nuk na çon gjëkund. Kjo ishte edhe ajo që tha sekretari i Përgjithshëm dhe që evidentoj edhe unë nga përgjigjja juaj. Pra, ju duhet të kishit pasur vëzhgues, duhet të kërkonit pranë Komisionit pamje filmike, duhet të na faktonit neve këtu që pse konkretisht ju doni të hapnit 1, 2, 5 apo 59 qendra votimi për X arsye. Po, zoti Bele.

Z. K. Bele: Avokat, ju parashtruat, midis të tjerave, faktin që ka një tendencë të pazakontë, në qoftë se e kuptova drejt, të votave të pavlefshme në këtë ZAZ, flasim për ZAZ-në nr. 74. Në tabelën përmbledhëse, që unë shoh tani, te ZAZ-ja nr. 73,



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

që janë 34 mijë zgjedhës, votuan 11.800, janë 416 vota të pavlefshme, te 74-ra janë 24 290 votues dhe janë 861; më matematikë të përputhur, më trend të qartë! Pra, të dyja këto ZAZ, si 73-shi, si 74-ta, po të marrim makinën ne, besoj se lëviz me presje dhjetore. Pra, nuk shoh, është e njëjta tendencë si për fletët, si për numrin e votuesve, madje dhe për votat e hedhura gabim 22 me 41. Pra, këtu procesi duket sikur është bërë me makinë, e them për të prapësuar argumentin, pavarësisht se ju përfaqësoni argumentin e kandidatit, i cili ka një pretendim dhe ju jeni përfaqësuesi ligjor, avokati, do ta mbron atë, por nuk qëndron as ky argument, midis të tjerave, për trendin dyshues të fletëve të pavlefshme në këtë kuti. Pra, të paktën këtë matematikë, kuptoj unë, në qoftë se e kam gabim, te lidhja 2, bashkëlidhur kësaj.

Z. Y. Merkaj: Mund të sqaroj diçka?

Z. E. Lako: Po zoti Merkaj.

Z. Y. Merkaj: Tek ankimi pretendohet që janë 2 qendra votimi, që nuk ka marrë vota. Ky është 3400 e 3641 /01, nëse mund të marrë pamjet filmike të shikojë, të tregojë që është hedhur një votë për PSD-në dhe nuk është rezultati. Kjo do të ishte një provë indicio, që mund të shërbente.

Z. E. Lako: Po ka të bëjë me atë që unë sapo sqarova.

Z. I. Hoxha: Kjo do na detyronte t'u kërkojmë votuesve të subjektit të vijnë të deklarojnë sot votën.

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

Z. E. Lako: Jo, jo nuk ndihmon as ajo.

Z. I. Rusmali: Nuk ndihmon as ajo, ka dhe komisionerë që marrin rrogën për shkak të emërimit, po votojnë subjektin tjetër dhe gënjejnë.

Z. I. Hoxha: Nuk e vë në diskutim atë, po ne nuk e lejojmë as veten si t'u kërkojmë sot të deklarojnë se për kë kanë votuar.

Z. E. Lako: Jo, bëhet fjalë që ju të kërkonit te KQZ-ja pamjet filmike të X-it, 1, 2 sa mund të shikoni dhe të vëreni aty ku e keni zero, a ka ndonjë votë të hedhur për PSD-në.

Z. I. Hoxha: E mirëkuptoj vlerësimin tuaj edhe arsyetimin tuaj, po ka një situatë, sepse grupet e numërimit, kur numërojnë, ne nuk mund të dallojmë se cila qendër votimi po numërohet dhe duhet të kalojmë apriori të gjitha qendrat, të gjitha filmimet, për të gjitha numërimet, sepse praktikisht fillon e numëron një qendër votimi dhe nuk arrijmë të konceptojmë se cila qendër është duke u numëruar.

Z. E. Lako: Shihet ajo.

Z. I. Hoxha: Dhe grupet dhe vëzhguesit tanë thjesht kanë “menaxhuar”, le të themi, votat e vlefshme tonat.

Z. E. Lako: E ka fleta e votimit dhe QV-në dhe të gjithë informacionin. Për këtë keni ndonjë koment? Domethënë kërkon kohë që ta plotësoni, ta rregulloni, ankimin, po kaq është ajo çfarë ju ...

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

Z. I. Hoxha: Për llogari të subjektit që përfaqësoj do të doja ta ezauroja këtë kohë, në tentativë për të paraqitur prova plotësuese, nëse ekzistojnë.

Z. K. Bele: Duhet marrë parasysh edhe një gjë, avokat, ndoshta e keni ndjekur apo jo, u hapën qarqe të tëra në zgjedhjet e kaluara për arsye të tjera dhe nuk lëvizën 300 vota. Që të lëvizin 300 vota në ZAZ duhet të kenë ardhur njerëzit me forca speciale nga tavani..

Z. I. Hoxha: Ne nuk pretendojmë ndryshim të rezultatit në 300 vota, por ne po diskutojmë mandatin e një këshilltari për 12 vota ose për 40 vota, nga 300. Pra, nuk është në atë prizëm. Ne nuk pretendojmë që na kanë marrë votat tona, por një pjesë e votave të pavlefshme u janë dhënë subjekteve të tjera dhe na kanë diskriminuar në kuptimin...

Z. I. Rusmali: Avokat, sipas Kodit të Procedurave Administrative barrën e provës lidhur me këtë pretendim e keni ju, nuk e kemi ne. Ju keni ardhur këtu që të na e kërkonin ne barrën e provës. Nuk ju ndihmojmë dot. Ne jemi trupa që gjykojmë pretendimin, nuk jemi as pala tjetër.

Z. I. Hoxha: Është e kuptueshme.

Z. I. Rusmali: Mundësia procedurale që kemi ne është që t'ju japim 24 orë kohë për të plotësuar kërkesën ankimore, por duhet të jeni i vetëdijshëm për faktin që

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

kërkesa ankimore juaja më pak se kaq nuk mund të kishte, është e zhveshur nga çdo provë, ka vetëm pretendime nga burime jozyrtare, nga thëniet e përfaqësuesve tanë, apo ku di unë, por ka vetëm pretendime, nuk ka asnjë provë. Ne e marrim dhe e çojmë në procedurë një kërkesë pa prova fare, por 24 orë kohë mund t'ju japim që ju ta bëni me prova. Në qoftë se ju në këto 24 orë kohë e bëni me prova, hajdeni, sillni provat që të mbështesni pretendimet tuaja. Në qoftë se nuk e bëni dot, besoj e merrni parasysh, e merrni me mend se cili do mund të jetë rezultati.

Z. I. Hoxha: Është e kuptueshme.

Z. E. Lako: Nëse nuk ka ndonjë koment tjetër, as nga pala, sekretari i Përgjithshëm kërkon që të jepet kohë siç e tha një herë, edhe pala bie dakord me këtë argument, atëherë edhe KAS-i, i konsultuar në vend, vendos që t'ju jap 24 orë afat për ta plotësuar këtë kërkesë me gjithë faktet, argumentet dhe objektin e saj në përputhje me ligjin, në mënyrë që të bëhet e kalueshme për në seancë. Nesër, të martën, kërkesa duhet të vijë deri në orën 13.00 dhe për seancën e radhës do t'ju njoftojmë nëpërmjet administratës se kur do të zhvillohet. Faleminderit! Me kaq e deklaroj të mbyllur këtë seancë.

Vendimi nr. 156

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

**29.05.2023
Ora 12.56**

RENDI I DITËS

**“Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr. 89, subjekti ankues Paryia drejtësi,
Integrim dhe Unitet”**

PJESËMARRJA:

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele (Mungon z. Ledio Braho)
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema
- **Parti politike** PDIU (K. Xhemali)
- **Të tjerë:**

Z. E. Çefa: Deklarojmë të çelur seancën për shqyrtimin e elementeve të formës dhe të përmbajtjes të kërkesë ankimore nr. 89, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet, me inicialet PDIU, me objekt ankimi: “Kundërshtimi i vendimit të KQZ-së për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve të zonës zgjedhore Bashkia Delvinë. Ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit në zonën zgjedhore Bashkia Delvinë për këshillin bashkiak”. Sipas shortit të hedhur në KQZ, relator i kësaj kërkesë jam caktuar unë anëtari Elvis Çefa. Verifikojmë fillimisht prezencën. Është prezent trupa e KAS-it në përbërje të së cilës janë katër anëtarë, fakt që nuk e pengon këtë trupë të vijojë me shqyrtimin e kësaj kërkesë për shkak se kuorumi është i plotësuar. Është prezent përfaqësuesi i palës ankuese. Ju lutem, prezantohuni.

**Zbardhi materialin audio
Alma KOLA**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

Z. K. Xhemali: I pranishëm Klardi Xhemali.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Është prezent sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe administrata e tij. Shkurtimisht, kërkesa paraprake në këtë fazë kemi?

Z. K. Xhemali: Jo, nuk kemi.

Z. E. Çefa: Nuk ka kërkesa paraprake. Kërkesa për subjekte të interesuara nuk ka. Atëherë vijojmë duke ia dhënë fjalën sekretarit të Përgjithshëm për një parashtrim të shkurtër të elementeve të formës dhe të përmbajtjes së kësaj kërkesë.

Z. Y. Merkaç: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore nr. 89, me ankues subjektin Paria Drejtësi, Integrim dhe Unitet, e cila kundërshton vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për zonën zgjedhore Bashkia Delvinë për këshillin e kësaj bashkie.” Nga verifikimi paraprak i elementeve formale, konstatohet se i plotëson tri elementet formale, si: kompetencën e KAS-it për shqyrtimin e kërkesës, si legjitimin e ankuesit dhe afatin brenda të cilit është bërë ankimi. Megjithatë, mund të them se argumenti i kërkesës nuk qëndron, pasi Komisioneri e ka vendosur, por kjo i takon themelit, e ka bërë llogaritjen e herësit dhe të ndarjes së mandatave sipas nenit 162, pika 4, ku argumenti i palës thotë që unë kam 245 vota, kurse partia që ka marrë 3 mandate ka 251, që ndan herësi. Pra, është dukshëm që është 4-5 vota më shumë. Megjithatë, kërkoj të kalojë në seancë për shqyrtim. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Përfaqësuesi i palës ankuese për këtë fazë vetëm të procedimit keni ndonjë gjë?

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

Z. K. Xhemali: Po, i nderuar zoti gjyqtar, ne mendojmë që i plotësojmë të gjitha kriteret për të kaluar në seancë gjyqësore. Për sa i takon çështjes që shtoi sekretari i Përgjithshëm, mendoj se është çështja në themel dhe do ta shqyrtojmë në themel e do të japim pretendimet tona.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Nga kolegët a ka pyetje? Po, zoti Rusmali.

Z. I. Rusmali: Ju keni aplikuar formulën e Kodit për ndarjen e mandateve?

Z. K. Xhemali: Po, i nderuar.

Z. I. Rusmali: Dhe si ju del?

Z. K. Xhemali: Ne gjykojmë që na takon mandati për arsye sepse PDIU-ja ka 5,02%.

Z. I. Rusmali: Jo, mos më jep shpjegime. Formulën e Kodit e keni aplikuar?

Z. K. Xhemali: Sipas nesh, mendojmë që...

Z. I. Rusmali: Pse nuk na e keni bashkëlidhur kërkesën?

Z. K. Xhemali: Po duke gjykuar që është në themel çështja sot...

Z. I. Rusmali: Do të na i sillni formulën?

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

Z. K. Xhemali: Do ta sjellim siç e kemi lexuar ne dhe si e mendojmë ne. Do të argumentojmë qëndrimin tonë.

Z. E. Çefa: KAS-i, i konsultuar në vend, vendosi kalimin për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 89 dhe seanca e themelit do të jetë ditën e nesërme, më 30 maj, në orën 15:30 minuta. Me kaq këtë seancë e deklaroj të mbyllur. Faleminderit!

Vendimi nr. 157

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

29.05.2023
Ora 13.02

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr. 90, subjekti ankues koalicioni “Bashkë Fitojmë””

PJESËMARRJA:

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele (Mungon z. Ledio Braho)
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema
- **Parti politike** PS (Z. M. Legisi)
- **Të tjerë:**

Z. K. Bele: Çelim seancën për verifikimin e elementeve të formës dhe përmbajtjes për kërkesën ankimore nr. 90 e datës 26.5.2023, me objekt: “Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 545, datë 23.5.2023”. Prezent është KAS me katër anëtarë në kuorum, si dhe administrata e KQZ-së me sekretarin e Përgjithshëm. Nga pala ankuese në këtë fazë nuk kemi deklarime apo kërtime. Pala ankuese nuk verifikohet prezent. Ka kërkesa për pjesëmarrje nga palë të treta?

Z. Y. Merkaj: Po, është përfaqësuesi i Partisë Socialiste që ka bërë kërkesë për të ndërhyrë si palë e interesuar në këtë shqyrtim.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

Z. K. Bele: Me shkaqet tuaja, avokat, jemi njohur në raste të ngjashme. I konfirmoni?

Z. M. Legisi: I konfirmoj.

Z. K. Bele: Kërkesa pranohet, kështu që vazhdojmë. Zoti Merkaj, shumë shkurt ku konsiston edhe qëndrimi juaj.

Z. Y. Merkaj: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore nr. 90, me ankues koalicionin “Bashkë Fitojmë”, e cila ankimon vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr. 545, datë 23.5.2023, i cili ka miratuar tabelën përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjet për kryetar dhe për këshillin e bashkisë zona zgjedhore Bashkia Lezhë për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Nga verifikimi paraprak i kërkesës konstatohet se kërkesa ka përshkrim të shkurtër të shkeljes së pretenduar, përshkrimi i fakteve dhe argumenteve me dispozitat tek të cilat është mbështetur ankimi, si dhe tregimi i provave, të cilat kërkohen të merren gjatë procesit administrativ të shqyrtimit. Në këto kushte i kërkojë KAS-it ta kthejë kërkesën për plotësim, pasi të plotësohen provat mbi të cilat mbështetet ankimi. Faleminderit!

Z. K. Bele: Kemi pyetje?

Z. E. Lako: Pala ankuese është lajmëruar, ka konfirmuar? Po nuk qe pala ankuese kë do të pyesim.

Z. K. Bele: Ne vazhdojmë edhe pa pyetur palën ankuese...

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

Z. E. Lako: Vetëm të pyesim zotin Merkaj, por zoti Merkaj nuk besoj se ka ndonjë informacion më tepër.

Z. Y. Merkaj: Po t'i referohesh ankimit, duhet theksuar atmosfera që u zhvilluan zgjedhjet ishte mbytëse, besueshmëria e zgjedhësve ishte e vogël, janë gjëra të përgjithshme që nuk kanë lidhje me ankimin.

Z. K. Bele: Meqenëse jemi në një situatë të ngjashme me ankimin e mëparshëm, kërkesa e sekretarit të Përgjithshëm është që t'i japim 24 orë afat. Keni ndonjë gjë për të deklaruar?

Z. M. Legisi: Jo, nuk kam. Faleminderit!

Z. K. Bele: Në qoftë se nuk ka pyetje...

Z. E. Çefa: Në njoftimin që do t'i bëhet subjektit, ju lutem, personi që do ta njoftojë, t'i bëjë të qartë se kanë listuar si provë procesverbalet përkatëse, por, në fakt, nuk i shoh këtu mbrapa. Nëse i kanë, t'i sjellin. Edhe librat e protokollit. Porosia është që një nga elementet që duhet të plotësojnë, duhet të jenë edhe këto provat e listuara që vetë i kanë listuar, pra të na i vënë në dispozicion nga një kopje.

Z. K. Bele: Në njoftim të qartësohet plotësim sipas kërkesave të ligjit, si dhe plotësim me provat e listuara, që të jemi të qartë. Duke qenë se nuk kemi pyetje në këtë fazë, qëndrimi i sekretarit u bë prezent, KAS-i, i konsultuar në vend, vendos dhënien 24 orë afat për plotësimin e elementeve të kërimit, të provave, elementeve të tjera sipas

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

nenit të Kodit të Procedurave Administrative. Në këto kushte, orari i caktuar do të jetë dita e nesërme në orën 13.15 si afat për të administruar këto prova. Me kaq seancën e deklaroj të mbyllur.

Vendimi nr. 158

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

29.05.2023
Ora 13.10

RENDI I DITËS

“Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr. 91, subjekti ankues Partia Lëvizja e Legalitetit”

PJESËMARRJA:

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele (Mungon z. Ledio Braho)
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj
- **Parti politike** PLL (Z. Lurian Mena)
- **Të tjerë:**

Z. I. Rusmali: Çelim seancën për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 91, paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Lëvizja e Legalitetit, me objekt kërkesë për shpallje pavlefshmërie të zgjedhjeve në qendrat e votimit nr. 1766/02, nr. 1537/11 dhe nr. 1986/01 të zonës zgjedhore Bashkia Tiranë. Prezent është trupa e KAS-it, me përbërjen e katër anëtarëve. Është sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, zoti Ylli Merkaj, me ekipin e tij, dhe përfaqësuesi i Partisë Lëvizja e Legalitetit.

Z. L. Mena: Lurian Mena.

Z. I. Rusmali: Ju jeni me autorizim?

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

 1

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

Z. L. Mena: Po.

Z. I. Rusmali: Me autorizim nga subjekti zgjedhor. Ju lutem, jepjani administratës. Paraprakisht keni ndonjë kërkesë paraprake drejtuar kësaj trupe? Ndonjë kundërshtim për ndonjë nga anëtarët tanë?

Z. L. Mena: Lidhur me kërkesën?

Z. I. Rusmali: Keni kërkesë për përjashtimin e ndonjërit prej nesh?

Z. L. Mena: Jo, absolutisht.

Z. I. Rusmali: Ndonjë deklaram kolegët nuk kanë. Kjo seancë është paraprake dhe ne shqyrtojmë vetëm disa elemente të kërkesës, nuk futemi në themelin e saj. Shqyrtojmë praktikisht të drejtën për të vënë në lëvizje trupën me kërkesën sipas këtij objekti. Do të shprehet fillimisht sekretari i Përgjithshëm për elementet. Dëgjoje me vëmendje që të mund të japësh ti reagimin tënd.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore nr. 91, me ankues Partia Lëvizja e Legalitetit, e cila ankimon vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr. 542 “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për kryetar të bashkisë dhe këshillin e bashkisë në zonën zgjedhore Bashkia e Tiranës për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Nga verifikimi paraprak i kërkesës, ashtu siç relatova dhe dy kërkesat e para, i mungon përshkrimi i shkurtër i shkeljes së pretenduar, i mungon tregimi i provave, që kërkohen të

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

merren gjatë procedimit administrativ, si dhe mungon përshkrimi i fakteve, i argumenteve dhe dispozitat ligjore tek të cilat mbështetet ankimi. Është një ankim, një argumentim, një arsyetim i përgjithshëm, i cili nuk ka asnjë provë konkrete dhe fakt konkret për shkeljet e pretenduara. Duke qenë se mbajtëm të njëjtin qëndrim edhe në dy kërkesat e para, i kërkojmë KAS-it ta shtyjë për plotësim duke i dhënë palës ankuese 24 orë kohë. Faleminderit!


Z. I. Rusmali: Faleminderit, zoti Merkaj! Cili është mendimi juaj për këtë parashtrim?

Z. L. Mena: Dëgjova pak me vështirësi zotërinë, sepse ishte mikrofoni larg. Gjithsesi ajo që desha të theksoja është që ne nuk ndodhemi këtu për të ndryshuar rezultatin e zgjedhjeve, sepse bëhet fjalë vetëm për tri kuti, dhe jam i bindur që, sido që të ishte, pra edhe nëse do të numëroheshin nuk është se do të kishte efekt në rezultatin e subjektit tonë. Ajo që duam ne është që kërkesa jonë të merret në konsideratë, prova fakte për këtë nuk kemi, por, duke qenë se vetë kam qenë vëzhgues dhe vëzhguesit e tjerë nga informacionet, që kemi, lidhur me informacionin që është marrë nga vëzhguesit është bërë dhe kërkesa për ankimim për këto tri kuti. Ne duam që kërkesa të merret parasysht dhe të tregojmë që realisht ka një vullnet të mirë për të vënë drejtësinë në vend..

Z. I. Rusmali: Faleminderit! A ka pyetje nga kolegët?

Z. E. Lako: A mundet ju, se siç u tha, nuk është se ka prova të mjaftueshme për pretendimin, për më tepër që edhe ju vetë pretendimit i referoheni jo në përkthim në mandate, por thjesht që të shohim sa vota mund të keni se mund të ketë ndonjë

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

3


*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

mangësi. Ju nga kaq sa keni paraqitur, a mund të paraqitni ndonjë provë tjetër përveç kësaj?

Z. L. Mena: Ne si subjekt nuk kemi pasur të drejtë për të pasur numërues te qendrat e numërimit, por duke pasur të drejtën e vëzhguesve kemi qenë aty të pranishëm që nga momenti i fillimit të numërimit deri në fund. Dhe sigurisht që kemi pasur kontestime edhe gjatë numërimit, por prova nuk mund të kemi, sepse ne kemi qenë thjesht vëzhgues. Si mund të sajojmë prova? Prova nuk mund të sajojmë. Unë e thashë qartë se ne nuk kemi ardhur këtu për të kërkuar ndryshimin e rezultatit, sepse sado të ketë vota aty nuk do të bëjnë asnjë lloj efekti për subjektin tonë, por thjesht duam të tregojmë se ne jemi për drejtësi. Kjo është e gjitha.

Z. I. Rusmali: Po, zoti Çefa.

Z. E. Çefa: Ndoshta kjo i përket mbase më mirë themelit të çështjes, por, gjithsesi, meqenëse në këtë fazë ju deklaroni se nuk keni prova, atëherë, a mund të na i përshkruani ato konstatime që ju keni vënë re në procesin e votimit që sipas jush e bënte të pavlefshëm rezultatin në këto tri qendra votimi që ankimoni sot? Pra, çfarë karakter shkeljesh ishin ato në mënyrë që ta bëjnë të pavlefshëm rezultatin?

Z. L. Mena: Karakteri i shkeljeve konstaton në faktin që numri i votave që numërohen nga ana e vëzhguesve nuk përkonte me rezultatin që dilte në procesverbal në fund të numërimit.

Z. E. Çefa: A keni provuar të kërkonit kamerat pamjet video këtu në KQZ dhe pastaj ju me stafin tuaj t'i sqaronit këto momente dhe t'i ballafaqoni. Dhe sigurisht kur të

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

jeni të sigurt pastaj që ashtu mund të vini dhe t'i paraqitni. Kjo mund të përbënte një fillim prove edhe për KAS-in. Pra, mund të përbënte një indicie që ne pastaj të fillonim dhe kërkonim prova apo këqyrje më të hollësishme për të verifikuar faktet.

Z. L. Mena: Jo, ne nuk e kemi bërë një gjë të tillë. Konstatimet tona kanë qenë të themi konkrete në vend gjatë procesit të numërimit.

Z. I. Rusmali: Nuk ka pyetje tjetër. Ne kemi një mundësi t'ju japim 24 orë kohë që ju të gjeni këto prova dhe të na i sillni kërkesën bashkë me provat, sigurisht duke e modifikuar pak siç tha dhe sekretari i Përgjithshëm, duke plotësuar arsyetimin, por dhe duke e rregulluar pak objektin, sepse ju po kërkonit pavlefshmëri me shkresë, ndërkohë që me gojë po kërkonit një gjë tjetër, por kërkonit ndryshimin e rezultatit për këto qendra votimi. Këtë korrigjim të objektit dhe provat që mbështesin pretendimin tuaj ne më shumë se 24 orë kohë nuk ju lëmë dot. Ju duhet të na i sillni, sepse përndryshe nuk e shqyrtojmë dot për hir të dëshirës për ta shqyrtuar, ne nuk hapim kuti për hir të vullnetit të mirë për të hapur kuti. Ne jemi në procedurë ankimore, nëse ka ankime ka pretendime të bazuara në prova ne të bëjmë hetim dhe hetimi përfshin edhe këqyrjen e kutive. Por duhet të vijë nga ju prova. Mekanizmin e keni, sepse mekanizmi është shumë i thjeshtë për t'u implementuar, KQZ-ja me një kërkesë të thjeshtë ju vë në dispozicion videon e numërimit të këtyre tri qendrave. Do ta bëni ju këqyrjen e videos, duhet të dilni ju me tabelën tuaj të rezultateve dhe të na thoni, ne e kemi parë, ne e kemi kontrolluar, jo me llafë njerëzish, por me dokument dhe na rezulton që rezultati është i ndryshëm, në fakt, nga ai që është deklaruar zyrtarisht. Kjo është procedura ligjore. A e doni këtë 24 orësh kohë?

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

Z. L. Mena: Patjetër që do ta donim. Thjesht duhet të bëjmë një kërkesë këtu në KQZ për këtë?

Z. I. Rusmali: Sa të mbarosh këtu te protokollu kërkesë për vënien në dispozicion të pamjeve video për këto 3 qendra votimi.

Z. K. Bele: Do të harxhoni kohë, sepse do vërtetë punë ajo. Pra, nuk është një gjë që merr atë dhe e sheh menjëherë, do të harxhosh kohë dhe të shikosh që në kutinë iks dalin 5 vota në procesverbal dhe unë shoh 7. Pra, nëse nuk ngre një pretendim të tillë, pra ky është qëllimi, se çfarë bëni ju është tjetër, por po jua thjeshtojmë në këtë pikë.

Z. I. Rusmali: KAS-i, në përfundim të këtij shqyrtimi paraprak, vendos që t'ia kthejë për plotësimin kërkesën subjektit zgjedhor Partia Lëvizja e Legalitetit, sipas asaj që u trajtua këtu. Dhe kërkesa e plotësuar të dorëzohet deri nesër në orën 13.30, me qëllim që ne pastaj të mundet ta rishqyrtojmë dhe të vendosim eventualisht ta marrim dhe ta shqyrtojmë në themel. Këtu mbyllet seanca.

Vendimi nr. 159

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

29.05.2023
Ora 13.22

RENDI I DITËS

“Projektvendim “ Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 77, subjekti Aleanca Progresiste LZHK”

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Parti politike:** S’ka prezent
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. K. Bele: Çelim seancën e shqyrtimit në themel të kërkesës ankimore numër 77, me ankues subjektin zgjedhor Aleanca Progresiste LZHK kundër vendimit numër 74 datë 15.05.2023 dhënë nga KZAZ-ja 15 Kurbin. Relatojmë se seanca e kaluar është shtyrë, pasi iu kërkua nga pala dhe të sillet kutia e qendrës së votimit numër 0907, që i përket fshatit Shpërthet, njësia administrative Mamurras Kurbin me qëllim këqyrjen e saj fizike, pasi pretendimi kryesor në këtë kuti është pavlefshmëria në këtë çështje është bërja e pavlefshme e një kutie për të cilën subjekti ankues ka pretenduar se kjo kuti është e rregullt dhe për këtë qëllim votat e saj duhet të numërohen pasi ka ndikim në rezultat. Sekretari i Përgjithshëm, vizualisht shohim se kemi kutinë prezente të fletëve të votimit. A mund të na afrohet kutia që ta këqyrim dhe të jetë prezente për efekt të rekordit? A mund ta vendosni, ju lutem

*Zbardhi materialin audio
Mirgjeta LEKAJ*


*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

mbi tavolinë? Gjithashtu, për procedure konstatojmë se përfaqësuesi i ankuesit nuk është prezent, dhe palë të tjera nuk ka. Në këtë fazë nuk ka as kërkime apo deklarime të tjera që kanë të bëjnë me seancën. Ylli, cili është qëndrimi juaj?

Z. Y. Merkaj: Atëherë, si procedurë, në momentin që nga Komisioni i Qendrës së Votimit dorëzohet dokumentacioni zgjedhor nga KZAZ-ja, grupi i marrjes në dorëzim, i caktuar nga KZAZ-ja dhe pasi shikon, verifikon kutinë e shpall që në atë moment të parregullt. Kjo kuti nuk i nënshtrohet numërimit të votave/nga konstatimi që shohim nga këqyrja e kutisë duket qartë që ajo është një kuti që mund të të lërë vend që mund të futet fletët e votimit nga çarja në fund të kutisë, ku është një hapësirë shumë e madhe, që mund të futet dhe mund të jetë e manipuluar, dhe mendojmë që KZAZ-ja vepruar në përputhje me nenin 115 të Kodit Zgjedhor që e ka konsideruar që në fillim të marrjes në dorëzim si kuti e parregullt dhe nuk i është nënshtuar numërimit.

Z. K. Bele: Me sy të lirë dallohet qartë që në pjesën e fundit të kutisë është një dëmtim masiv, i cili bën të mundur ndërhyrjen potenciale, dhe, në vlerësimin tim, nuk garanton integritetin e kësaj kuti dhe paprekshmërinë e fletëve të votimit. Në pamje të parë, të paktën këtë konstatoj unë, duket se vendimi i KZAZ-së ka qenë vendim i marrë në përputhje me ligjin dhe rrethanat faktike. A keni ndonjë gjë?

Z. E. Lako: Kjo besoj është pasqyruar edhe te libri i protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së, ky fakt, apo jo? Pra, që është vlerësuar kuti e parregullt.

Z. E. Çefa: Kutia e materialeve zgjedhore nuk është dëmtuar.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

Z. K. Bele: Atëherë, në këto kushte, Ylli, KAS-i nuk vlerëson që kutia duhet të hapet dhe të bëhet numërim apo rivlerësim, pasi nuk ka objektivisht, në mënyrë të qartë jemi para një kutie të dëmtuar qartësisht. Kështu që, ju lutem, pretendimet tuaja në përfundim të shqyrtimit.

Z. Y. Merkaç: Në përfundim të shqyrtimit kërkojmë rrëzimin e kërkesës së subjektit zgjedhor Aleanca Progresiste LZHK, për kërkesën ankimore numër 77. Faleminderit!

Z. K. Bele: Duke qenë se nuk kemi pyetje të tjera KAS-i i konsultuar në vend vendos pushimin e shqyrtimit, lidhur me kërkesën ankimore numër 77, të kërkuarit Aleanca Progresiste LZHK. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 5 ditësh në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Me kaq seanca deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 160

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

**29.05.2023
Ora 14:00**

RENDI I DITËS

**"Për mos pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr.84, subjekti ankues:
Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë".**


PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema, Znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:**
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. I. Rusmali: Riçelim seancën e shqyrtimit paraprakë për kërkesën ankimore të ankusit Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë. E cila ishte ndërprerë për ti dhënë mundësinë subjektit që të bënte plotësimin dhe korrigjimin e kërkesës ankimore. Përfaqësuesi i subjektit nuk është prezent sot në shqyrtim ndërkohë që është njoftuar dhe nuk ka dhënë asnjë shpjegim as për mungesën as për prezencën. Mirë, zoti Sekretar i Përgjithshëm a është plotësuar kërkesa në vlerësimin tuaj?

Z. Y. Merkaj: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka ardhur plotësimi i kërkesës ankimore nr.84, nga verifikimi paraprak konstatohet se nuk ka plotësuar asnjë nga elementët e kërkuar në kërkesën e parë. Në këto kushte kërkojmë rrëzimin e kërkesës.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.29.05.2023*

Z. I. Rusmali: Në rregull, faleminderit! Kolegët kanë pyetje? Nuk ka! Atëherë, KAS i konsultuar në vënd, vendos: Rrëzimin e kërkesës për mos plotësim sipas afatit të elementëve të formës dhe të përmbatjes. Gjë që e bën të pamundur futjen për shqyrtim të saj. Këtu e mbyllim këtë seancë.

Vendimi nr.161

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*

